



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo unutrašnjih poslova - Ministry of Internal Affairs

Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme,

Në mbështetje të Kapitullit VI, nenit 42, të Ligjit Nr. 05/L-132 për Automjete (Gazeta Zyrtare Nr. 15, 11.05.2017), nenin 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5. i Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, Nr. 34, 18 nëntor 2022), nenin 8, paragrafin 1.4. të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.04/2021 dhe Rregulloren (QRK) Nr. 03/2022, si dhe nenin 38, paragrafin 6. të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare, Nr. 15, 12.09.2011),

Nxjerr:

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MPB) NR. 04/2023 PËR REGJISTRIMIN E MJETEVE

Neni 1
Qëllimi

1. Ky udhëzim administrativ ka për qëllim të përcaktoj rregullat dhe procedurat e regjistrimit, llojet e regjistrimit dhe çlajmërimin e mjetit.
2. Po ashtu, ky udhëzim administrativ përcakton përmbajtjen dhe dimensionet e certifikatës për regjistrimin e mjeteve, targave të regjistrimit, mënyrën e udhëheqjes së evidencës për mjetet e regjistruara dhe përmbajtjen e sistemit elektronik të regjistrimit të automjeteve.
3. Ky udhëzim administrativ është pjesërisht në përputhje me Direktivën e Këshillit 1999/37/EC e 29 prillit 1999 për dokumentet e regjistrimit të mjeteve.

Neni 2
Fusha e veprimit

Dispozitat e këtij udhëzimi administrativ janë të obligueshme për pronarët e mjeteve që i nënshtrohen procedurës së regjistrimit, si dhe për të gjitha Qendrat e Regjistrimit të Automjeteve në Republikën e Kosovës.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shkurtesat dhe termat e përdorur në këtë udhëzim administrativ kanë këtë kuptim:
 - 1.1. **MPB** - nënkupton Ministria e Punëve të Brendshme;
 - 1.2. **MPJD** - nënkupton Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
 - 1.3. **ARC** – nënkupton Agjencia për Regjistrim Civil;
 - 1.4. **DRA** - nënkupton Drejtorati për Regjistrim të Automjeteve;
 - 1.5. **QRA** - nënkupton Qendra e Regjistrimit të Automjeteve;
 - 1.6. **CRA** - nënkupton Certifikata e Regjistrimit të Automjetit;
 - 1.7. **ATK** - nënkupton Administrata Tatimore e Kosovës;
 - 1.8. **AAPSK** - nënkupton Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar;
 - 1.9. **ARBK** - nënkupton Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës;
 - 1.10. **SRA** - nënkupton Sistemi i Regjistrimit të Automjeteve;
 - 1.11. **SIPK** – nënkupton Sistemi Informativ i Policisë së Kosovës;
 - 1.12. **Numri identifikues** - nënkupton Numri identifikues (VIN), (numri i shasisë) së automjetit;
 - 1.13. **Regjistrimi i mjetit të ri** - nënkupton mjetin i cili nuk ka qenë më parë i regjistruar në ndonjë shtet tjetër por regjistrohet për herë të parë në Kosovë.
2. Shprehjet e tjera të përdorura në këtë udhëzim administrativ e kanë kuptimin ashtu siç është përcaktuar në Ligjin përkatës për Automjete.

Neni 4 Regjistrimi i mjeteve

1. Regjistrimi i mjeteve sipas nenit 5 të këtij udhëzimi administrativ, bëhet në të gjitha qendrat për regjistrimin e automjeteve të rajonit përkatës, pavarësisht vendbanimit apo vendqëndrimit të pronarit të mjetit. Ndërsa formulari i transferit me rastin e çlajmërimit të mjetit, do të merret në qendrën përkatëse ku e ka vendbanimin ose vendqëndrimin.

2. Për të gjitha shërbimet për regjistrimin e mjeteve, kërkohet edhe patentë shoferi për persona fizik me afat, konform kategorisë përkatëse, të dhënat merren nga sistemi i patentë shoferëve.

3. Paragrafi 2. i këtij neni, nuk vlen për moped dhe motoçikleta, kapaciteti i motorit të cilëve nuk është më i madh se 125 cm/kub dhe fuqia e motorit nuk është më e madhe se deri 11kv, si dhe proporcioni i fuqisë së motorit të mjetit me masën e mjetit nuk e tejkalon 0.1 kv/kg. Po ashtu, për triçikletat e kategorisë L5E, tek të cilat fuqia e motorit nuk e kalon 15 kg, të cilat janë në pronësinë e të miturit, i cili posedon patentë shofer për kategorinë e mjetit në fjalë.

4. Pronari i mjetit nuk mund ta regjistrojë mjetin në qoftë se ka edhe mjete të tjera të regjistruara në sistemin e regjistrimit të automjeteve, e të cilave iu ka kaluar afati i regjistrimit më tepër se një vit.

5. Pronari i mjetit sipas paragrafit 4. të këtij neni, obligohet që paraprakisht ta regjistroj ose ta bëj çlajmërimin e mjetit që është pasiv:

5.1. Të jap deklaratën me shkrim në qoftë se ai mjet është shkatërruar dhe është jashtë përdorimit. Deklarata ruhet në arkivin e QRA-së;

5.2. Mjeti i cili nuk çlajmërohet në mënyrë automatike, kalon në pasiv dhe largohet nga regjistrimet aktive në sistem, ndërsa mbetet në histori të mjeteve të pronarit.

6. Pronari i mjetit nuk mund ta bëj regjistrimin apo vazhdimin e regjistrimit të mjetit, as ndërrimin e pronarit, pa e bërë shlyerjen e gjobave për kundërvajtje në trafikun rrugor, ashtu siç e parasheh Ligji për Automjete.

7. Kërkesën për regjistrim të mjetit mund ta bëj edhe personi i autorizuar, me autorizim të vërtetuar nga noteri apo nga gjykata, duke poseduar njërin nga këto dokumente:

7.1. Letërnjoftim;

7.2. Pasaportë ose patentë shofer për personin fizik;

7.3. Fotokopjen e certifikatës dhe informatës së biznesit, për personin juridik.

8. Me përjashtim të rasteve nga paragrafi 7. i këtij neni, vazhdimin e regjistrimit mund ta bëjnë edhe anëtarët e ngushtë të familjes.

Neni 5

Llojet e regjistrimit të mjetit

1. Llojet e regjistrimit të mjetit janë si në vijim:

1.1. Regjistrimi i mjetit të ri;

1.2. Regjistrimi i parë;

- 1.3. Vazhdimi i regjistrimit;
- 1.4. Riregjistrimi në rast të ndërrimit të pronarit;
- 1.5. Legalizimi;
- 1.6. Riregjistrimi;
- 1.7. Regjistrimi me targa provuese;
- 1.8. Regjistrimi i përkohshëm;
- 1.9. Regjistrimi i mjeteve me afat të kufizuar;
- 1.10. Regjistrimi i mjeteve me vlerë muzeore;
- 1.11. Regjistrimi i mjeteve të dedikuara ekskluzivisht për gara.

Neni 6

Regjistrimi i mjetit të ri

1. Për regjistrimin e mjetit të ri, kërkohen dokumentet si në vijim:
 - 1.1. Dokument i vlefshëm i Republikës së Kosovës që përmban të dhënat personale si: letërnjoftim, pasaportë apo patentë shoferi valid për kategorinë përkatëse;
 - 1.2. Certifikata e konformitetit dhe kontrata e shitblerjes nga auto sallonet dhe kompanitë e licencuara për shitje të mjeteve;
 - 1.3. Dëshmia e kryerjes së obligimeve doganore;
 - 1.4. Certifikata e homologimit të mjetit me përjashtim të rasteve kur mjete është i liruar nga procedura e homologimit;
 - 1.5. Certifikata mbi konfirmimin e rregullsisë teknike të mjetit e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se tridhjetë (30) ditë nga dita e lëshimit;
 - 1.6. Polica e sigurimit nuk duhet të jetë më e vjetër se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e lëshimit;
 - 1.7. Dëshmia e pagesës së taksës komunale të automjetit, përjashtimisht kategoritë e liruara nga taksat sipas legjislacionit në fuqi;

- 1.8. Patentë shoferi i vlefshëm për kategorinë përkatëse, për personat fizik, përjashtimisht kategoritë e liruara sipas nenit 52 të Ligjit për Automjete.
2. Shtetasit e huaj të cilët posedojnë leje qëndrimi të përkohshëm ose përhershëm, mund të regjistrojnë mjetet me targat e rregullta, në rastet kur i kanë përmbushur obligimet doganore. Afati i regjistrimit të mjetit lidhet me skadimin e leje qëndrimit.
3. Të dhënat për pronarin e mjetit merren përmes ndërlidhjes nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile për persona fizik, dhe nga ATK-ja dhe ARBK-ja për persona juridik.
4. Në rastin kur zhdoganimi është paguar në emër të autosallonit apo kompanisë së licensuar nga ARBK për shitjen e mjeteve i cili është i regjistruar në ARBK- MTI, për këtë veprimtari duhet që pronari i mjetit të prezantojë kontratën e shitblerjes nga autosalloni apo kompania e licensuar për shitje.
5. Vërtetimi i përcaktimit sipas paragrafit 4. të këtij neni nga QRA-ja, bëhet përmes të dhënave të ARBK-së për autosallonet e regjistruara dhe/apo të dhënave për kompanitë e licencuara për shitjen e mjeteve nga ARBK.
6. Regjistrimi i mjetit në pronësinë e fëmijës ose në pronësinë e të miturit, regjistrohet në emër të njërit prind, kujdestarit, prindit adoptues, si dhe bartësit të përdoruesit të mjetit. Në këto raste, dispozitat ligjore të cilat vlejnë për pronarin e mjetit, zbatohen edhe për përdoruesin e mjetit. Në CRA regjistrohet edhe emri dhe mbiemri i përdoruesit dhe numri i autorizimit.
7. Regjistrimi i mjetit në pronësinë e personit të rritur që nuk posedon patentë shoferin, pronari i mjetit cakton një përdorues të mjetit me autorizim të noterizuar. Në këtë rast, dispozitat ligjore të cilat vlejnë për pronarin e mjetit, zbatohen edhe për përdoruesin e mjetit.
8. Paragrafi 5 dhe 6 i këtij neni, nuk vlen për moped dhe motoçikleta, kapaciteti i motorit të cilëve nuk është më i madh se 125 cm/kub dhe fuqia e motorit nuk është më e madhe se deri 11kv, si dhe proporcioni i fuqisë së motorit të mjetit me masën e mjetit nuk e tejkalon 0.1 kv/kg. Po ashtu për triçikletat e kategorisë L5E, tek të cilat fuqia e motorit nuk i kalon 15 kg, të cilat janë në pronësinë e të miturit, i cili posedon patentë shofer për kategorinë e mjetit në fjalë.
9. Paragrafët 5, 6 dhe 7, të këtij neni, vlejnë për të gjitha llojet e regjistrimit të parapara në nenin 5 të këtij udhëzimi administrativ.
10. Mjeti në pronësi të personit juridik regjistrohet në bazë të certifikatës së biznesit dhe pronari duhet të ofroj kopjen e certifikatës dhe informatës së biznesit, dokumentin e vlefshëm të identifikimit letërnjoftimin, pasaportën apo patentë shoferin valid për kategorinë përkatëse.
11. Për mjetin në pronësi të organizatës joqeveritare apo institucionit shtetëror, regjistrimi i tij bëhet sipas certifikatës fiskale, ndërsa të dhënat merren përmes ndërlidhjes nga ATK dhe ARBK.
12. Në rastet kur janë disa bashkëpronarë, mjeti regjistrohet në emër të njërit bashkëpronar me një deklaratë me shkrim prej bashkëpronarëve të tjerë, të vërtetuar në gjykatë ose nga noteri.

13. Për mjetet e institucioneve shtetërore, nevojitet edhe kartela identifikuese e zyrtarit nga institucioni përkatës. Ndërsa për mjetet e ndërmarrjeve publike, nevojitet autorizimi dhe kartela identifikuese nga institucioni përkatës.

14. Rimorkiot e lehta nuk regjistrohen por vetëm duhen të pajisen me targa dhe të sjellin kopjen e certifikatës së kontrollit teknik, në të cilën është shënuar data e kontrollit të parë teknik dhe afatin e kontrollit të ardhshëm teknik.

15. Zyrtari përgjegjës i QRA-së, në rast të dyshimit në dokument, e njofton udhëheqësin e QRA-së i cili përmes drejtorit të DRA-së e njofton Inspektoratin e ARC-së.

16. Pas plotësimit të kushteve të përcaktuara në këtë nen dhe verifikimit të dokumenteve nga zyrtari përgjegjës, QRA do të lëshojë fletëpagesën sipas vendimit për caktimin e tarifave të lëshuar nga ministri i MPB-së.

Neni 7 **Regjistrimi i parë**

1. Për regjistrimin e parë të mjetit nevojitet si në vijim:

1.1. Dokumenti i prejardhjes së mjetit, librezë e origjinës;

1.2. Nëse pala nuk posedon dokumentin origjinal të mjetit librezën e origjinës, mund ta dorëzoj kopjen e librezës me të cilën është kryer procedura e zhdoganimit, të vërtetuar apo konfirmuar nga dogana, si dhe raportin policor për humbjen e librezës;

1.3. Dëshmia e kryerjes së obligimeve doganore. Në rastin kur zhdoganimi është bërë në emër të autosallonit apo kompanisë së licencuar nga ARBK për shitjen e mjetit i cili është i regjistruar në ARBK- MTI për këtë veprimtari nga MTI, pronari i mjetit duhet të paraqes kontratën e shitblerjes nga autosalloni apo kompania e licencuar për shitje. Me këtë rast, zyrtari i QRA-së obligohet ta konsultoj listën e autosalloneve apo të kompanive të licencuar për shitje të regjistruara nga ARBK ose përmes sistemit *online*;

1.4. Certifikata e homologimit të mjetit me përjashtim të rasteve kur mjete është i liruar nga procedura e homologimit;

1.5. Certifikata mbi konfirmimin e rregullsisë teknike të mjetit e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se tridhjetë (30) ditë nga data e lëshimit;

1.6. Polica e sigurimit, nuk duhet të jetë më e vjetër se pesëmbëdhjetë (15) ditë e nga data e lëshimit;

1.7. Dëshmia e pagesës për taksën komunale të automjetit, përjashtimisht kategoritë e liruara nga taksat sipas legjislacionit në fuqi;

1.8. Dokument i vlefshëm i Republikës së Kosovës që përmban të dhënat personale si: letërnjoftim, pasaportë apo patentë shofer;

1.9. Për shtetasit e huaj të cilët posedojnë lejeqëndrim të përkohshëm ose përhershëm, mund të regjistrojnë mjetet me targat e rregullta, në rastet kur i kanë të përmbushura obligimet doganore. Afati i regjistrimit të automjetit lidhet me skadimin e lejeqëndrimit;

1.10. Të dhënat për pronarin e mjetit merren përmes ndërlidhjes nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile për persona fizik dhe nga ATK dhe ARBK për persona juridik;

1.11. Patentë shoferi i vlefshëm për kategorinë përkatëse, për persona fizik, përjashtimisht kategoritë e liruara sipas nenit 3, pikës 3 të këtij udhëzimi administrativ. Të dhënat për patentë shoferin merren përmes ndërlidhjes nga sistemi i patentë shoferëve.

2. Rimorkiot e lehta nuk regjistrohen, por vetëm duhen të pajisen me targa dhe të sjellin kopjen e certifikatës së kontrollës teknike, në të cilën është shënuar data e kontrollit të parë teknik dhe afatin e kontrollit të ardhshëm teknik.

3. Automjetet e konfiskuara të cilat në bazë të vendimit gjyqësor apo vendimit të AAPSK për dorëzim me qëllim të shfrytëzimit nga Qeveria, mund të regjistrohen pa iu nënshtruar obligimit doganor.

4. Për mjetet sipas paragrafit 3. të këtij neni të cilat në sistemin e regjistrimit të automjeteve figurojnë se më parë kanë qenë të regjistruara në QRA, mund të bëhet regjistrimi i tyre edhe në mungesë të CRA-së dhe targave që kanë poseduar më parë këto mjete.

5. Pas plotësimit të kushteve të përcaktuara në këtë nen dhe verifikimit të dokumenteve nga zyrtari përgjegjës, QRA do të lëshojë fletëpagesën sipas vendimit për caktimin e tarifave nga ministri i MPB-së.

Neni 8 Vazhdimi i regjistrimit

1. Për vazhdimin e regjistrimit të mjetit kërkohen dokumentet si në vijim:

1.1. CRA e lëshuar nga QRA;

1.2. Certifikata mbi konfirmimin e rregullsisë teknike të mjetit e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se tridhjetë (30) ditë nga data e lëshimit;

1.3. Polica e sigurimit nuk duhet të jetë më e vjetër se pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga data e lëshimit;

1.4. Dokument i vlefshëm i pronarit të mjetit që përmban të dhënat personale, letërnjoftim, pasaportë e Republikës së Kosovës apo patentë shoferi;

- 1.5. Patentë shoferi i vlefshëm për kategorinë përkatëse, përjashtimisht kategoritë e liruara sipas nenit 3, paragrafin 3. të këtij udhëzimi administrativ;
- 1.6. Dëshmia e pagesës së taksës komunale e mjetit përjashtimisht kategoritë e liruara nga taksat sipas legjislacionit në fuqi;
- 1.7. Mjeti i cili është i regjistruar në emër të personit juridik, pronari duhet të paraqes fotokopjen e certifikatës së biznesit, informatën e biznesit dhe dokumentin e identifikimit të vlefshëm, letërnjoftimin, pasaportën ose patentë shoferin;
- 1.8. Kërkesën për vazhdim të regjistrimit mund ta bëjë edhe personi i autorizuar, me autorizim të vërtetuar nga noteri apo nga gjykata, duke poseduar kopjen e dokumentit të identifikimit të pronarit dhe të personit të autorizuar;
- 1.9. Për vazhdimin e regjistrimit sipas nën paragrafit 1.8. të këtij paragrafi, nevojitet patentë shoferi i pronarit i vlefshëm për kategorinë përkatëse, ndërsa për personin juridik kopja e certifikatës dhe informatës së biznesit;
- 1.10. Përjashtim nga nën paragrafi 1.8. i këtij neni, kërkesën për vazhdim të regjistrimit të mjetit mund ta bëjnë edhe familjarët e pronarit të mjetit, duke ofruar kopjen e dokumentit identifikues letërnjoftim, pasaportë, patentë shofer të vlefshëm të pronarit të mjetit, anëtari i gushtë i familjes e nënshkruan deklaratën të cilën ia ofron zyrtari përgjegjës i QRA-së.
2. Mjetet e reja të cilat marrin pjesë në trafikun rrugor, do t'i nënshtrohen kontrollit teknik katër vjet pas regjistrimit të parë.
3. Kërkesa për vazhdimin e regjistrimit mund të bëhet tridhjetë (30) ditë para kalimit të afatit të regjistrimit të mëparshëm. QRA është e obliguar të bëjë vazhdimin e regjistrimit të mjetit nga data e skadimit të afatit të regjistrimit.
4. Procedura për vazhdimin e regjistrimit të mjetit mund të bëhet edhe *online*, përmes ueb aplikacionit. Për rastet e vazhdimit të regjistrimit *online*, pas përfundimit të procesit të aplikimit dhe konfirmimit të pagesës, pala duhet të paraqitet në QRA për ta vulosur CRA-në.
5. Të dhënat për dokumentet nga paragrafi 1.2. deri 1.5. të këtij neni, merren *online*, pa pasur nevojë që origjinali të ruhet në arkivat e QRA-së.
6. Pas plotësimit të kushteve të përcaktuara në këtë nen dhe verifikimit të dokumenteve nga zyrtari përgjegjës, QRA do të lëshojë fletëpagesën sipas vendimit për caktimin e tarifave të lëshuar nga ministri i MPB-së. Ndërsa për rastet e aplikimit *online*, QRA vetëm do të vulos dhe nënshkruaj CRA-në.

Neni 9 **Ndërrimi i pronësisë**

1. Për ndërrimin e pronësisë nevojiten dokumentet si në vijim:

- 1.1. CRA e çlajmëruar e pronarit paraprak;
 - 1.2. Dëshmia e pronësisë kontrata e shitblerjes, kontrata në rast dhurate, akti i trashëgimisë, dokument me anë të të cilit dëshmohet pronësia, të vërtetuar nga noteri ose nga gjykata, apo urdhrin e ekzekutueshëm nga përmbaruesi privat.
2. Me rastin e blerjes së mjetit në kompanitë e regjistruara nga organet përkatëse për shitblerjen e mjeteve nevojitet:
 - 2.1. Kontrata e shitblerjes e vërtetuar nga noteri ose gjykata, për automjetet që janë të regjistruara në emër të autosaloneve, apo kompanive të licencuar për shitjen e mjeteve;
 - 2.2. Polica e sigurimit në emër të pronarit të ri e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga data e lëshimit;
 - 2.3. Certifikata mbi konfirmimin e rregullsisë teknike të mjetit e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se tridhjetë (30) ditë nga dita e lëshimit;
 - 2.4. Dokument i vlefshëm identifikues i Republikës së Kosovës i pronarit të mjetit, letërnjoftimi, pasaporta ose patentë shoferi. Të dhënat merren përmes ndërlidhjes nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile, ndërsa të dhënat për patentë shoferin merren përmes ndërlidhjes nga sistemi i patentë shoferëve;
 - 2.5. Patentë shoferi i vlefshëm për kategorinë përkatëse, për persona fizik, përjashtimisht kategoritë e liruar sipas nenit 52 të Ligjit për Automjete;
 - 2.6. Mjeti në pronësi të personit juridik regjistrohet në bazë të certifikatës së biznesit, pronari duhet të prezantojë fotokopjen e certifikatës dhe informatës së biznesit dhe dokumentin e vlefshëm të identifikimit të Republikës së Kosovës (letërnjoftimin, pasaportën ose patentë shoferin), ndërsa për organizata joqeveritare apo institucionet shtetërore, regjistrimi bëhet sipas certifikatës fiskale. Të dhënat merren përmes ndërlidhjes nga ATK dhe ARBK;
 - 2.7. Për mjetet e institucioneve shtetërore për ndërrimin e pronësisë, nevojitet dëshmia nga institucioni për bartjen e pronësisë apo dhënies në shfrytëzim të mjetit në institucionin tjetër;
 - 2.8. Për mjetet të cilat shiten në ankand publik, duhet të sjellin dëshminë e shitjes së institucionit përkatës. Ndërsa, në rast të blerjes nga pala e tretë, duhet të sigurohet kontrata e shitblerjes e vërtetuar nga noteri ose nga gjykata;
 - 2.9. Dëshmia e pagesës së taksës komunale në emrin e pronarit të ri.
 3. Targat e mjetit të çlajmëruar brenda rajonit të njëjtë, mund të përdoren nga pronari i ri i mjetit.
 4. Pas plotësimit të kushteve të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni dhe verifikimit të dokumenteve nga zyrtari përgjegjës, QRA do të lëshoj fletëpagesën sipas vendimit për caktimin e tarifave nga ministri i MPB-së.

Neni 10

Legalizimi i mjeteve

1. Mjetet të cilat për një arsye apo tjetër janë regjistruar në mënyrë jo të rregullt, i nënshtrohen procesit të legalizimit pas përfundimit të procedurave administrative dhe ligjore.
2. Për legalizimin e mjetit nevojitet:
 - 2.1. Vendimi ose vërtetimi nga Policia e Kosovës, prokuroria, ose gjykata i cili dëshmon se automjeti nuk ka pengesa ligjore për regjistrim;
 - 2.2. Certifikata mbi konfirmimin e rregullsisë teknike të mjetit e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se tridhjetë (30) ditë nga dita e lëshimit;
 - 2.3. Polica e sigurimit e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga data e lëshimit;
 - 2.4. Dëshmia e kryerjes së obligimeve doganore;
 - 2.5. Dokument i vlefshëm identifikimi i pronarit, letërnjoftimi, pasaporta e Republikës së Kosovës ose patentë shoferi;
 - 2.6. Të dhënat e pronarit merren përmes ndërlidhjes nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile, ndërsa të dhënat për patentë shoferin merren përmes ndërlidhjes nga sistemi i patentë shoferëve;
 - 2.7. Patentë shoferi i vlefshëm për kategorinë përkatëse, për persona fizik, përjashtimisht kategoritë e lira sipas nenit 52 të Ligjit për Automjete;
 - 2.8. Certifikata e homologimit, duke i përjashtuar rastet kur janë të lira nga procedura e homologimit;
 - 2.9. Taksa komunale për mjete, përjashtimisht rastet e lira nga taksat sipas legjislacionit në fuqi;
 - 2.10. Në qoftë se ka ndërrim pronësie, duhet edhe dëshmia për pronësinë sipas nën paragrafit 1.2. të nenit 8 të këtij udhëzimi administrativ.
3. Mjeti paraprakisht para legalizimit, duhet të çlajmërohet.
4. Pas plotësimit të kushteve të përcaktuara në këtë nen dhe verifikimit të dokumenteve nga zyrtari përgjegjës, QRA do të lëshoj fletëpagesën sipas vendimit për caktimin e tarifave të lëshuar nga ministri i MPB-së.

Neni 11

Riregjistrimi i mjetit

1. Në rast kur mjete është i çlajmëruar dhe kërkohet nga pala të bëhet riregjistrimi, nevojiten këto dokumente:
 - 1.1. CRA-ja e çlajmëruar;
 - 1.2. Certifikata mbi konfirmimin e rregullsisë teknike të mjetit, e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se tridhjetë (30) ditë nga data e lëshimit;
 - 1.3. Polica e sigurimit, e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga data e lëshimit;
 - 1.4. Taksa komunale, duke përjashtuar automjetet të cilat janë të liruara nga taksa komunale;
 - 1.5. Në rast të ndërrimit të pronarit kërkohet kontrata e shitblerjes së mjetit;
 - 1.6. Dokument identifikimi i pronarit i Republikës së Kosovës: letërnjoftimi, pasaporta e vlefshme ose patentë shoferi. Të dhënat merren përmes ndërlidhjes nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile, ndërsa të dhënat për patentë shoferin merren përmes ndërlidhjes nga sistemi i patentë shoferëve;
 - 1.7. Patentë shoferi i vlefshëm për kategorinë përkatëse për persona fizik, përjashtimisht kategoritë e liruara sipas nenit 52 të Ligjit për Automjete.
2. Pala e cila i ka përmbushur kushtet nga paragrafi 1. i këtij neni, pajiset me targa të reja dhe CRA të re, nëse nuk janë ruajtur targat për një vit, ndërsa CRA-ja e vjetër mbetet në arkiv.
3. Mjetet që shiten në ankand publik të cilat më parë janë konfiskuar nga organet kompetente, mund të riregjistrohen bazuar në vendimin e -gjykatës, dëshmi të AAPS-së, dhe apo organeve të tjera sipas legjislacionit në fuqi.
4. Në këto raste sipas paragrafit 3. të këtij neni, transaksioni i ndryshimit të pronësisë bartet tek blerësi-fituesi në ankandet e rregullta publike i cili më parë duhet të kryej obligimet sipas nenit 9 të këtij udhëzimi administrativ, duke përjashtuar nën paragrafin 1.2. të nenit 9.
5. Automjetet e konfiskuara të cilat në bazë të vendimit gjyqësor dhe legjislacionit në fuqi bëhen pronë e shtetit, sipas vendimit të AAPSK-së për dorëzim në shfrytëzim nga Qeveria, mund të regjistrohen edhe pa iu nënshtruar obligimit doganor.
6. Për mjetet sipas paragrafit 3. të këtij neni që në sistemin e regjistrimit të automjeteve figuron se më parë kanë qenë të regjistruara në QRA, mund të bëhet riregjistrimi i tyre edhe në mungesë të CRA-së dhe targave që ka poseduar më parë ky mjet.

7. Në rastet kur dështon ankandi publik sipas paragrafit 3. të këtij neni, ndërrimi i pronësisë mund të bëhet edhe me urdhër të Organit Përmbarues, sipas legjislacionit në fuqi.

8. Për mjetet që më parë janë çlajmëruar dhe duhet të bëhet bartja e pronësisë, edhe nëse blerësi i takon një komunë tjetër, mund të ri regjistrohen në QRA-në e rajonit përkatës, pavarësisht vendbanimit apo vendqëndrimit të qytetarit.

9. Fletëtransferi nga QRA-ja ku ka qenë i regjistruar mjete më parë mund të bëhet në mënyrë fizike dhe elektronike.

10. Regjistrimi i mjetit të çlajmëruar bëhet duke përfshirë taksat për reregjistrim sipas vendimit për caktimin e tarifave nga ministri i MPB-së.

Neni 12

Lëshimi i targave provuese

1. Lëshimi i targave provuese nuk nënkupton regjistrimin e rregullt të mjetit.

2. Targat provuese vendosen për identifikimin e mjetit dhe janë mundësi për qasje në komunikacionin rrugor për kohën e përcaktuar sipas këtij neni.

3. Targat provuese mund të lëshohen për mjete motorike dhe bashkëngjitëse.

4. Targat provuese lëshohen nga QRA sipas kërkesës së pronarit të mjetit, në këto raste:

4.1. Për mjetet e reja;

4.2. Për mjetet e përdorura dhe të riparuar me të cilat kryhet vozitja provuese për testimin e mjetit dhe gjendjes së tij;

4.3. Mjetet që lëvizin nga selia e ndërmarrjes prodhuese deri në selinë e ndërmarrjes që i shet;

4.4. Për mjetet që lëvizin në panairë apo autosallone për qëllim të shitjes;

4.5. Mjetet që lëvizin për t'i dërguar në kontrollim teknik të cilave iu ka skaduar regjistrimi dhe sipas kërkesës së palës.

5. Për lëshimin e targave provuese kërkohen këto dokumente:

5.1. Dëshmia e pronësisë;

5.2. Dëshmia e pagesës së taksave administrative;

5.3. Polica e sigurimit e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e lëshimit.

6. Me rastin e lëshimit të targave provuese, pronarit i lëshohet vërtetimi për shfrytëzimin e targave i cili përmban:

6.1. Emrin dhe mbiemrin e pronarit të mjetit;

6.2. Qëllimin e përdorimit të mjetit;

6.3. Llojin e mjetit, marka, modeli, numri i identifikues (shasisë) i mjetit, ngjyra dhe afati i përdorimit të targave provuese.

7. Targat provuese lëshohen me afat deri në pesëmbëdhjetë (15) ditë. Pas skadimit të këtij afati, pala obligohet që t'i kthej targat në QRA.

8. Në rast kur pala nuk i kthen targat në afatin e caktuar, QRA obligohet të njoftoj Policinë e Kosovës.

9. Targat provuese mund të lëshohen sipas kërkesës së palës në QRA-në më të afërt me pikën kufitare të hyrjes së mjetit.

10. Përjashtimisht paragrafit 5. të këtij neni, ministri me vendim mund të përcaktoj targa provuese në një afat më të gjatë kohor.

11. Në raste të veçanta targat provuese mund t'i lëshoj edhe policia kufitare e cila obligohet që të mbaj evidenca për targat të cilat do të lëshohen në kufi dhe t'i ruaj të dhënat në sistemin SRA përmes WEB shërbimit.

12. Tarifat për këtë lloj të targave do të përcaktohen me vendim të Ministrit të MPB-së.

Neni 13 Regjistrimi i përkohshëm

1. Në Republikën e Kosovës, regjistrohen mjetet, pronarët e të cilave janë shtetas të huaj me lejeqëndrim të përkohshëm ose të përhershëm, të cilët regjistrojnë mjetet e tyre sipas rregullave doganore apo kërkesave të importit të përkohshëm (automjetet përkohësisht të importuara) dhe përdoren sipas kontratës “*leasing*”, ose kontratës së bashkëpunimit afarist të kontraktuara ndërmjet kompanive me seli në Republikën e Kosovës dhe kompanive tjera me seli në ndonjë shtet tjetër, si dhe automjetet të cilat janë të destinuara për manifestime sportive, ekonomike. Për këto mjete lëshohet certifikata e regjistrimit me afat vlefshmërie prej 1 viti.

2. Personat me qëndrim të përkohshëm, mund t'i regjistrojnë mjetet në pronësi të tyre me targa të përkohshme.

3. Targat e përkohshme nuk mund të jepen në afat më të shkurt se 60 ditë e as në afat më të gjatë se dymbëdhjetë (12) muaj.

4. Mjetit me targa të përkohshme nuk mund t'i vazhdohet regjistrimi, nëse nuk e ka vazhduar importi i përkohshëm dhe nëse nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni.
5. Gjatë kohës kur automjeti është me targa të përkohshme nuk mund të shitet, dhurohet, falet apo çfarëdo mënyre tjetër e ndërrimit të pronarit.
6. Përfundimisht paragrafit 5. të këtij neni, kur mjeti është me targa të përkohshme, mund të shitet, dhurohet, falet apo çfarëdo mënyre tjetër e ndërrimit të pronarit në rast se çlajmërohet dhe i nënshtrohet procedurës doganore. Në rastin e ndërrimit të pronarit kërkohet kontrata e shitblerjes.
7. Dokumentet e nevojshme për regjistrim të përkohshëm të mjetit, për mjetet e reja kërkohen dokumentet e përcaktuara në nenin 6 të këtij udhëzimi administrativ, si dhe lejeqendrimi i përkohshëm ose përhershëm.
8. Ndërsa dokumentet e nevojshme për regjistrim të përkohshëm të mjetit i cili posedon librezë, kërkohen dokumentet e përcaktuara në nenin 7 të këtij udhëzimi administrativ, si dhe lejeqendrimi i përkohshëm ose i përhershëm.
9. Kur plotësohen kushtet nga paragrafi 7. i këtij neni, për regjistrimin e mjetit, QRA obligohet t'i lëshoj:
 - 9.1. Targat për regjistrim të përkohshëm;
 - 9.2. CRA-në për regjistrim të përkohshëm.
10. Pas kalimit të afatit të regjistrimit të përkohshëm të mjetit, me kërkesën e palës, QRA është e obliguar t'ia kthej librezën e origjinës, ndërsa CRA e regjistrimit të përkohshëm vendoset në dosje.

Neni 14

Regjistrimi i mjeteve me afat të kufizuar

1. Regjistrimi i mjeteve me afat të kufizuar bëhet në këto raste:
 - 1.1. Kur shtetasi i huaj e transporton mjetin e blerë në Republikën e Kosovës, me qëllim që ta regjistrojë në ndonjë shtet tjetër, pas përfundimit të qëndrimit të tij në Republikën e Kosovës;
 - 1.2. Kur shtetasi i huaj e transporton mjetin jashtë vendit me qëllim që t'i nënshtrohet përpunimeve apo përmirësimeve.
2. Për regjistrimin e mjeteve sipas paragrafit 1. të këtij neni, nevojiten dokumentet si në vijim:
 - 2.1. Kërkesa për regjistrim me afat të kufizuar;

- 2.2. Polica e sigurimit (në rastet kur nuk ka regjistrim);
 - 2.3. Lejeqëndrimi i përkohshëm;
 - 2.4. Certifikata e rregullsisë teknike të mjetit, e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se tridhjetë (30) ditë nga dita e lëshimit;
 - 2.5. Dëshmia e eksportit nga dogana;
 - 2.6. Patentë shoferi, me afat për kategorinë përkatëse. Të dhënat për patentë shoferë merren përmes ndërlidhjes nga sistemi i patentë shoferëve.
3. Për mjetet që kanë qenë të regjistruara në Republikën e Kosovës të cilat janë vjedhur e që më vonë janë gjetur në ndonjë shtet tjetër, nevojiten dokumentet si në vijim:
 - 3.1. Kërkesa për regjistrim me afat të kufizuar;
 - 3.2. Letërnjoftimi, pasaporta e Republikës së Kosovës e vlefshme ose patentë shoferi;
 - 3.3. Raporti policor;
 - 3.4. Polica e sigurimit, në rastet kur i ka skaduar regjistrimi.
 4. Afati kohor i certifikatës së regjistrimit të mjetit nuk mund të jetë më i gjatë se tridhjetë (30) ditë.

Neni 15

Pajisja me targa diplomatike

1. Mjetet e misioneve diplomatike dhe konsullore, si dhe mjetet e përdorura nga misionet e huaja, autoritetet ndërkombëtare, zyrat e huaja përfaqësuese në Republikën e Kosovës dhe personeli i tyre, pajisen me targa diplomatike sipas legjislacionit, proceduarave dhe kërkesave nga MPJD.
2. Mjetet e stafit civil të misioneve diplomatike dhe konsullore do të regjistrohen sipas shkresës së aprovuar nga MPJD.
3. Dokumentet e nevojshme për regjistrimin e automjeteve me targa diplomatike bëhet sipas legjislacionit dhe proceduarave të MPJD-së.

Neni 16

Regjistrimi i përkohshëm i mjeteve për personelin e misioneve ndërkombëtare apo organizatave ndërkombëtare të përcaktuara me ligj

1. Regjistrimin e përkohshëm të mjetit mund ta bëjnë edhe personeli i misioneve ndërkombëtare apo organizatave ndërkombëtare të përcaktuara me ligj.

2. Regjistrimi i përkohshëm i mjetit nga paragrafi 1. i këtij neni, mund të bëhet vetëm me kartelë pune të vlefshme të lëshuar nga misioni apo organizata përkatëse.

3. Në këto raste pala duhet ta afrojë dëshminë nga misioni apo organizata që i lejohet regjistrimi apo vazhdimi i regjistrimit të automjetit me targa të përkohshme.

Neni 17

Regjistrimi i mjeteve për kompanitë e huaja tregtare

1. Për regjistrimin e mjeteve për kompanitë e huaja tregtare nevojiten dokumentet si në vijim:

1.1. Kontrollimi teknik;

1.2. Polica e sigurimit, e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e lëshimit;

1.3. Kontrata e bashkëpunimit afarist ndërmjet kompanive me seli në Republikën e Kosovës dhe kompanive tjera me seli në ndonjë shtet tjetër;

1.4. Dëshmia e kryerjes së obligimeve doganore;

1.5. Për personat juridik, certifikata e biznesit e regjistruar në Republikën e Kosovës;

1.6. Ndërsa për OJQ-të, certifikata fiskale e regjistruar në Republikën e Kosovës.

Neni 18

Regjistrimi i mjeteve me vlerë muzeore

1. Mjeti me vlerë muzeore konsiderohet mjeti i cili është më i vjetër se tridhjetepesë (35) vjet, i cili është i ruajtur dhe teknikisht i mirëmbajtur, si dhe përshtatet me strukturën dhe formën konstruktive origjinale.

2. Për regjistrimin e mjeteve muzeore nevojiten këto dokumente:

2.1. Dokumenti që përmban të dhënat e mjetit (prejardhja e automjetit);

2.2. Pronësia e automjetit;

2.3. Dëshmia mbi statusin e mjetit me vlerë muzeore;

2.4. Kontrolli teknik;

2.5. Polica e sigurimit e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e lëshimit;

- 2.6. Dëshmia e kryerjes së obligimeve doganore;
 - 2.7. Dokument identifikimi si letërnjoftim, pasaportë e vlefshme e Republikës së Kosovës ose patentë shoferi.
3. Për regjistrimin e mjeteve me vlerë muzeore sipas këtij neni, lëshohen targa dhe CRA.
 4. Përmbajtja e targës së automjetit me vlerë muzeore duhet të përmbajë: kodin RKS, shkronjat ngjyrë ari, mbishkrimin historik, shkronjat ngjyrë të zezë, stemën e Republikës së Kosovës, numrin treshifror dhe Hyjneshën në Fron.

Neni 19

Regjistrimi i mjeteve të dedikuara ekskluzivisht për gara

1. Për regjistrimin e këtyre mjeteve, nevojiten këto dokumente:
 - 1.1. Dokumenti i prejardhjes;
 - 1.2. Certifikata mbi konfirmimin e rregullsisë teknike të mjetit, e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se tridhjetë (30) ditë nga dita e lëshimit;
 - 1.3. Dëshmia e kryerjes së obligimeve doganore;
 - 1.4. Polica e sigurimit;
 - 1.5. Dokument identifikimi si letërnjoftim ose pasaportë e vlefshme e Republikës së Kosovës ose patentë shoferi.

Neni 20

Çlajmërimi i mjetit

1. Pronari i mjetit të regjistruar mund ta bëjë çlajmërimin e mjetit me vetë dëshirë në QRA-në përkatëse.
2. Përfundimisht paragrafit 1. të këtij neni, pronari i mjetit të regjistruar obligohet të çlajmëroj mjetin nëse:
 - 2.1. Mjeti është i shkatërruar, amortizuar, aksidentuar, vjedhur;
 - 2.2. Mjeti do të regjistrohet në shtetin tjetër për arsye të shpërnguljes.
3. Për çlajmërimin e mjetit nga paragrafi 1. i këtij neni, nevojiten dokumentet si në vijim:
 - 3.1. Kërkesa për çlajmërim të automjetit;

- 3.2. Prezantimi i CRA-së;
- 3.3. Dorëzimi i targave të regjistrimit në QRA;
- 3.4. Në rastet kur mungojnë targat apo CRA-ja, duhet të posedojë raportin e policisë për humbje i cili duhet të arkivohet në dosje fizike dhe elektronike.
4. CRA e çlajmëruar i kthehet palës, ku evidentohet data e çlajmërimit.
5. Çlajmërimi i automjetit bëhet në bazën e të dhënave. Targat ruhen 1 vit për personin dhe automjetin e njëjtë, përjashtimisht targave të automjeteve të institucioneve shtetërore dhe diplomatike, targat ruhen me afat të pakufizuar.
6. Në rast të vdekjes së pronarit të mjetit, familja e ngushtë mund ta bëjë çlajmërimin e mjetit me dëshminë e certifikatës së vdekjes.
7. Dokumentet e nevojshme për çlajmërimin e mjetit sipas paragrafi 2. të këtij neni janë:
 - 7.1. Kërkesa për çlajmërim me arsyetimin e çlajmërimit;
 - 7.2. CRA-ja;
 - 7.3. Targat;
 - 7.4. Në rastet kur mungojnë CRA dhe targat, duhet raporti policor;
 - 7.5. Dëshmia për asgjësimin e mjetit të lëshuar nga qendra grumbulluese dhe çmontuese për automjete mbeturinë ose deklarata me shkrim të zyrtari i QRA-së nga pronari i mjetit për asgjësimin e mjetit;
 - 7.6. Dokument identifikimi, si letërnjoftim, pasaportë e vlefshme e Republikës së Kosovës ose patentë shoferi i vlefshëm për kategorinë përkatëse;
 - 7.7. Nëse automjeti është vjedhur/aksidentuar, pronari duhet të dorëzojë raportin e policisë si dëshmi për çlajmërim.
8. Përveç pronarit, kërkesën për çlajmërimin e mjetit mund ta bëjë edhe ndonjë person tjetër i autorizuar nga pronari, me autorizimin e vërtetuar nga noteri apo në gjykatë.
9. Përjashtimisht nga paragrafi 5. i këtij neni, pronari i targave regjistruese të mjetit nuk është i obliguar t'i dorëzojë targat regjistruese, nëse mjete është dhuruar, dhe si i tillë regjistrohet me të njëjtat targat dhe në emër të pronarit të ri.
10. Targat për pronarin e ri të targave regjistruese të mjetit sipas paragrafit 9. të këtij neni, vlen vetëm për rastet brenda rajonit të njëjtë.

Neni 21
Lëshimi i CRA-së dhe i targave

1. Për mjetin e regjistruar lëshohet CRA dhe targat e regjistrimit nga QRA.
2. Për çdo ndryshim të të dhënave në lidhje me regjistrimin e automjeteve, ndryshimet teknike apo vendbanimin, pala duhet që brenda tridhjetë (30) ditëve, të lajmërohet në QRA për ndryshimet përkatëse.
3. Mjetet e trafikut rrugor duhet të mbajnë dy targa të regjistrimit, përveç motoçikletës, mopedit, katërçikletave të lehta, katërçikletave, triçikletave me motor, mjeteve bashkëngjitëse, traktorit dhe rimorkios, të cilat lejohen të kenë një targë regjistrimi.
4. Nëse pronari i automjetit është shoqatë lizingu, në CRA shënohet pronari i automjetit, ndërsa në rubrikën për vërejtje shënohet edhe shfrytëzuesi i automjetit me lizing. Nëse shoqata lizing e jep pëlqimin me shkrim, mjete mund të regjistrohet në emër të përdoruesit, ndërsa në rubrikën vërejtje shënohet emri i shoqatës.
5. Nëse shoqata lizing jep pëlqimin me shkrim për transferin e automjetit në selinë/filialën tjetër, automjeti mund të transferohet.

Neni 22
Humbja, dëmtimi apo vjedhja e targave apo CRA-së

1. Për automjetet e regjistruara në rastin e humbjes apo vjedhjes së CRA-së ose targave të regjistrimit, pronari apo përdoruesi i mjetit duhet të lajmëroj stacionin më të afërt policor. Policia pas lajmërimit të rastit, duhet ta lëshoj dokumentin për humbjen apo vjedhjen e CRA-së ose targave, sipas pohimit të lajmëruesit.
2. Ky dokument duhet t'i përmbajë të dhënat e mjaftueshme për pronarin, mjetin, CRA-në ose targat.
3. Në rastin e dëmtimit të CRA-së, ose targave, pala duhet që CRA-në e dëmtuar ose targat, t'ia dorëzoj QRA-së dhe më pas ai e marrë CRA-në e re ose targat e reja të cilat i paguan sipas vendimit për caktimin e tarifave, ndërsa CRA e dëmtuar ose targat e dëmtuara arkivohen në QRA.
4. Pronari i mjetit duhet t'i ndërroj targat e regjistrimit me të reja, nëse njëra targë i ka humbur, dëmtuar, shkatërruar, amortizuar deri në atë masë që bëhet e papërdorshme.
5. Përgjashtimisht paragrafit 4. të këtij neni, institucionet shtetërore, ambasadat dhe organizatat ndërkombëtare, të cilat janë të pajisura me traga diplomatike, me rastin e dëmtimit të targës, mund të bëhet prodhimi i targës së njëjtë.
6. Targat e konfiskuara nga policia, nuk do t'i kthehen pronarit dhe do të asgjësohen.

7. Përrjashtim nga paragrafi 6. i këtij neni, institucioneve shtetërore do t'i kthehen targat dhe nuk do të asgjësohen.

Neni 23

Transferi i të dhënave për automjetin në rast të ndërrimit të vendbanimit

1. Me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më efikase për qytetarë, transferimi i të dhënave do të bëhet sipas vendbanimit të qytetarit për personin fizik, apo selisë dhe degës për personat juridik.
2. Në rast të ndërrimit të vendbanimit brenda regjionit, QRA është e obliguar të bëjë verifikimin e vendbanimit të palës në SRA.

Neni 24

Regjistrimi i mjeteve motorike para 10 qershorit 1999

1. Për mjetin e punës traktor, për të cilin pala nuk posedon dokument që e vërteton ekzistimin e tij në Kosovë para 10 qershorit 1999, pala mund ta regjistrojë traktorin me deklaratën e dy dëshmitarëve të vërtetuar nga noteri ose në gjykatë.
2. Pala nga paragrafi 1. i këtij neni mund ta bëjë regjistrimin në QRA duke i plotësuar kushtet nga paragrafët 1.2, 1.3, 1.4, 1.6, dhe 1.7. të nenit 11 të këtij udhëzimi administrativ.
3. Për automjetet e regjistruara në Kosovë para 10 qershorit 1999, nevojiten këto dokumente:
 - 3.1. Dokumenti për regjistrimin e fundit të automjetit dhe verifikimi nga arkivi;
 - 3.2. Në rastet kur mungon dokumenti për regjistrimin e automjetit, nga regjistrimi i fundit për çfarëdo arsye, atëherë nevojitet kopja e vërtetuar e dosjes e cila lëshohet nga organi kompetent i ngarkuar me arkivat të cilat i përmbajnë këto lëndë në DRA.

Neni 25

Modifikimi

1. Modifikimi nënkupton ndryshimin e të dhënave të automjetit në sistemin e regjistrimit të mjeteve dhe ndërrimin e CRA-së së dëmtuar nga QRA.
2. Me rastin e modifikimit nuk do të ndryshoj historiku i të dhënave në SRA.
3. Modifikimi i mjetit bëhet në këto raste:
 - 3.1. Kur me atest bëhet ndryshimi i të dhënave të mjetit, modifikimi i mjetit pranohet përmes ndërlidhjes së sistemeve me QAK;
 - 3.2. Për arsye të ndonjë gabimi teknik të QRA-ve, duhet të korrigjohen të dhënat e automjetit;

3.3. Për arsye të dëmtimit të CRA-së nga QRA, kjo CRA duhet të zëvendësohet me CRA të re duke mos ndryshuar historikun e deritanishëm të CRA-së.

4. Shërbimi i modifikimit nuk gjeneron pagesë.

Neni 26

Targat me porosi

1. Pronari i mjetit, me rastin e regjistrimit të automjetit të tij, ka të drejtë të bëjë porosi për targat me numrat dhe shkronjat e dëshiruara të cilat ndodhen në depon e MPB-së.

2. Numrat e zgjedhur janë treshifror, duke filluar nga numrat 101 deri në 999 dhe kombinimi i mundshëm i shkronjave.

3. Në rast se targat e kërkuara përmbajnë të njëjtin numër dhe shkronjë, në ndonjë automjet tjetër, pala obligohet të zgjedh numër ose shkronjë tjetër.

4. Pala personalisht, duhet të bëjë porosi për targat e dëshiruara në QRA, ose në mënyrë online përmes ueb shërbimit të ARC-së. Me këtë rast DRA obligohet që në afat brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, të sigurojë targat e kërkuara, ndërsa për porosinë online targat sigurohen brenda pesë (5) ditësh posa QRA-ja të pranoj dëshminë e pagesës nga pala.

5. Pas porosisë së targave, pala ka për obligim që brenda afatit deri në gjashtëdhjetë (60) ditë të paraqitet në QRA, për tu pajisur me targa. Nëse pala brenda këtij afati prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nuk paraqitet në QRA për t'u pajisur me targat e kërkuara, kërkesa e palës anulohet dhe targa mund të porositet nga pala tjetër.

6. Për pajisjen me targa me porosi, pala do të bëjë pagesë të veçantë në vlerën e përcaktuar me vendim të ministrit të MPB-së.

Neni 27

Xhamat e errët

1. Xhamat e errët mund t'i gëzojnë të gjithë qytetarët vetëm për ato mjete të cilat si të tilla janë të prodhuara nga vetë prodhuesi i automjetit.

2. Evidentimi i posedimit të xhamave të errët pas konstatimit të gjendjes teknike shënohet në CRA në rubrikën "shënime".

3. Vendosja e letrës së errët ngjitëse për hijezim në xhamat e automjetit është e ndaluar, përveç në mjetet e institucioneve shtetërore të cilat përcaktohen me vendim të ministrit të MPB-së.

Neni 28
Evidenca për regjistrimin e automjeteve

1. QRA mban evidencat mbi regjistrimin e automjeteve në dosje fizike dhe elektronike të QRA-së përkatëse.
2. Arkiva e automjeteve përbëhet nga dosjet e automjeteve, të cilat mbahen dhe rregullohen sipas numrit të targës së regjistruar të automjetit.
3. Dosjet fizike dhe elektronike të mjeteve të regjistruara ruhen në arkivat e QRA-së, deri në tridhjetë (30) vjet.
4. Ndërsa vazhdimet e regjistrimit të automjetit ruhen një (1) vit.
5. Evidentimi i të dhënave në sistemin SRA për regjistrimin e mjetit në programin elektronik bëhet sipas kërkesave për regjistrim të mjetit në QRA. DRA mban evidencat e të dhënave elektronike mbi regjistrimin e mjeteve të të gjitha QRA-ve në SRA.

Neni 29
Llojet e CRA-ve

1. Llojet e CRA-ve janë:
 - 1.1. CRA për regjistrimet e rregullta;
 - 1.2. CRA për regjistrime të përkohshme;
 - 1.3. CRA për regjistrim për mjete me afat të kufizuar;
 - 1.4. CRA për mjetet me vlerë muzeore;
 - 1.5. CRA për mjete për gara sportive.

Neni 30
Forma e CRA-së

1. Forma e CRA-së nga neni 28 i këtij Udhëzimi Administrativ për Regjistrim të Mjeteve përcaktohet si në vijim:
 - 1.1. Dimensionet e CRA-së janë 21 x 10.5 cm;
 - 1.2. Materiali special gjysmë plastik;
 - 1.3. Kodet mbrojtëse;

- 1.4. Ngjyra e gjelbër.
2. Kodet mbrojtëse përcaktohen me vendim të veçantë nga Ministri.

Neni 31
Përmbajtja e CRA-së

1. Certifikata e regjistrimit të mjetit përmban të dhënat si në vijim:
 - 1.1. Stema shtetërore;
 - 1.2. A. Numri i regjistrimit;
 - 1.3. I. Data e regjistrimit;
 - 1.4. C. Të dhënat personale;
 - 1.5. C.2. Pronari i mjetit;
 - 1.6. C.2.1 Mbiemri ose emri i biznesit;
 - 1.7. C.2.2. Emri;
 - 1.8. C.2.3. Adresa;
 - 1.9. B. Data e regjistrimit të parë;
 - 1.10. D. Automjeti;
 - 1.11. D.1. Prodhuesi;
 - 1.12. D.2. Tipi;
 - 1.13. D.3. Përshkrimi komercial;
 - 1.14. E. Numri identifikues (shasisë) i automjetit;
 - 1.15. S. Viti i prodhimit;
 - 1.16. S. Kapaciteti i ulëseve;
 - 1.17. S.1. Numri i ulëseve;
 - 1.18. S.2. Numri i vendeve për qëndrim;
 - 1.19. Q. Raporti fuqi/ peshë (në kw/ kg);

- 1.20. F. Pesha;
- 1.21. F1. Pesha maksimale e ngarkesës së lejuar;
- 1.22. G. Pesha e automjetit;
- 1.23. K. Homologimi;
- 1.24. P. Motori;
- 1.25. P1. Kapaciteti (në cm³);
- 1.26. P2. Fuqia maksimale neto (në kW);
- 1.27. P3. Lloji, karburanti ose burimi i energjisë;
- 1.28. R. Ngjyra e automjetit;
- 1.29. 2.A. Ndërtimi;
- 1.30. Shënimet.

2. Në rubrikën "shënime" evidentohen të gjitha ndërrimet e karakteristikave të cilat nuk janë paraparë në pikat e lartcekura.

3. Në pjesën e parë të CRA-së, shënohet emërtimi i CRA-së për qëllimin e përdorimit.

4. Në pjesën e dytë të CRA-së evidentohen të dhënat e vlefshmërisë së regjistrimit të mjetit motorik, nënshkrimi i zyrtarit dhe vula.

5. Në pjesën e dytë të CRA-së, (pjesa e mesme), evidentohen të dhënat e shënimeve tjera.

6. Në të gjitha faqet e CRA-së, në pjesën e poshtme të saj duhet të jenë të evidentuara shkronjat CRA dhe në vazhdim numri serik shtatë shifror i madhësisë pesë (5) mm, me ngjyrë të kuqe.

Neni 32 Llojet e targave

1. Llojet e targave të regjistrimit të mjetit janë:

- 1.1. Targa të rëndomta civile;
- 1.2. Targa për mjete motorike dhe rimorkio;
- 1.3. Targa për motoçikleta;

- 1.4. Targa për makinat bujqësore dhe rimorkio;
- 1.5. Targat provuese;
- 1.6. Targat për mjete me vlerë muzeore;
- 1.7. Targat për mjete të dedikuara për gara;
- 1.8. Targat për regjistrim përkohshëm;
- 1.9. Targat për automjetet e Policisë së Republikës së Kosovës;
- 1.10. Targat për mjete të Shërbimeve Emergjente;
- 1.11. Targat për mjetet e Doganës së Kosovës;
- 1.12. Targat për makinat speciale të punës;
- 1.13. Targat për automjetet e institucioneve të Republikës së Kosovës dhe atyre komunale;
- 1.14. Targat për institucionet e sistemit të drejtësisë.
- 1.15. Targat për agjencitë e pavarura.

Neni 33 **Format e targave**

1. Targat kanë formë horizontale dhe katrore.
2. Forma horizontale e targave, ka dimensione 52 x 11 cm, përdoret për:
 - 2.1. Targat e rëndomta;
 - 2.2. Targat provuese;
 - 2.3. Targat e përkohshme;
 - 2.4. Targat për automjete me vlerë muzeore dhe gara;
 - 2.5. Targat e institucioneve zyrtare;
 - 2.6. Targat e Policisë;
 - 2.7. Targat e Doganës së Kosovës;

- 2.8. Targat për Shërbimet Emergjente;
 - 2.9. Targat për sistemin e drejtësisë;
 - 2.10. Targat për makinat bujqësore.
3. Forma katrore e targave ka dimensione 34 x 20 cm, përdoret për:
- 3.1. Mjetet me konstrukcion për targa katrore;
 - 3.2. Makinat bujqësore, rimorkio dhe makinat speciale.
4. Format e targave për motoçikleta janë me dimensione 10 x 15 cm dhe 24 x 13 cm.

Neni 34

Përmbajtja e targave të rëndomta për automjete të personit civil

1. Targat horizontale të mjeteve duhet të jenë me ngjyrë të bardhë retro-reflektuese, numrat dhe shkronjat me ngjyrë të zezë, ndërsa korniza me ngjyrë të zezë me gjerësi katër (4) mm. Në të gjitha targat horizontale në pjesën e parë vertikale të targës e cila është ngjyrë e kaltër, vendoset kodi i Republikës së Kosovës RKS, me ngjyrë ari. Në vazhdim të targës shënohen shifrat e rajonit përkatës, të cilat kanë këtë domethënie:

- 1.1. për rajonin e Prishtinës -----01;
- 1.2. për rajonin e Mitrovicës -----02;
- 1.3. për rajonin e Pejës -----03;
- 1.4. për rajonin e Prizrenit -----04;
- 1.5. për rajonin e Ferizajt -----05;
- 1.6. për rajonin e Gjilanit -----06;
- 1.7. për rajonin e Gjakovës-----07.

2. Në vazhdim duhet të jetë stema shtetërore, numrat treshifror, pastaj viza horizontale. Në fund të targës shënohen dy shkronja të alfabetit standard latin duke filluar shkronjat nga A deri te shkronja Z, me përjashtim të shkronjave T, R, V, W, Y, X. Numri treshifror për targat e zakonshme, horizontale dhe katrore të regjistrimit të automjeteve do të fillojë nga numri 101, (shih shtojcën një (1).

3. Targat katrore të mjeteve duhet të jenë me ngjyrë të bardhë retro-reflektuese, numrat dhe shkronjat me ngjyrë të zezë, ndërsa korniza me ngjyrë të zezë, me gjerësi prej katër (4) mm, si në vijim:

3.1. Targa e formës katrore është e ndarë në dy pjesë të barabarta në drejtim horizontal. Në të gjitha targat katrore në pjesën e parë horizontale të targës e cila është ngjyrë e kaltër, vendoset kodi i Republikës së Kosovës RKS, me ngjyrë ari. Në mes të pjesës së parë horizontale shënohet shifra e rajonit përkatës, sipas paragrafit 1. të këtij neni, ndërsa në fund të pjesës së parë horizontale vendoset stema shtetërore;

3.2. Në pjesën e poshtme horizontale duhet të jenë numrat treshifror, viza horizontale dhe në fund të targës shënohen dy shkronja të alfabetit standard latin, kombinimi i shkronjave duhet të jetë nga shkronja A deri të shkronja Z, me përjashtim të shkronjës T, R, V, W, Y, X dhe e kombinuar me shkronjën U, shih shtojcën dy (2);

3.3. Targat katrore për rimorkio të mjeteve motorike, duhet të kenë sipërfaqen e targës me ngjyrë të bardhë retro-reflektuese, ndërsa numrat treshifror dhe shkronjat duhet të jenë me ngjyrë të kaltër, ndërsa korniza me ngjyrë të zezë me gjerësi 4mm. Në pjesën e parë të sipërme është i vendosur kodi i Republikës së Kosovës RKS, me ngjyrë të kaltër, shkronjat për kodin me ngjyrë ari, numri i rajonit përkatës dhe stema. Në pjesën e poshtme horizontale shënohen numrat treshifror, viza horizontale dhe kombinimi i shkronjave X dhe Y, duke filluar kombinimin me shkronjën A, shih shtojcën tre (3).

Neni 35

Përmbajtja e targave për motoçikleta të personit civil (rëndomta)

1. Targat për motoçikleta të personit civil duhet të jenë me ngjyrë të bardhë retro - reflektuese, shkronjat dhe numrat duhet të jenë me ngjyrë të zezë, korniza me gjerësi dy (2) mm, targa është e ndarë në dy pjesë të barabarta në drejtim horizontal me përmbajtje si në vijim:

1.1. Në targat me dimensione 10 x 15 cm në pjesën e parë horizontale të targës e cila është me ngjyrë të kaltër, vendoset kodi i Republikës së Kosovës RKS, me ngjyrë ari. Numri i rajonit përkatës, sipas paragrafit 1. të nenit 33 të këtij udhëzimi administrativ dhe stema shtetërore. Në mesin e pjesës së dytë horizontale duhet të shënohet numri treshifror. Në pjesën e poshtme horizontale duhet të shënohet viza horizontale dhe kombinimi i shkronjës R duke filluar me RA, shih shtojcën (3) tre. Ndërsa korniza me ngjyrë të zezë me gjerësi 2 mm, shih shtojcën katër (4);

1.2. Targat me dimensione 24 x 13 cm në pjesën e parë horizontale të targës e cila është me ngjyrë të kaltër, vendoset kodi i Republikës së Kosovës RKS, me ngjyrë ari. Numri i rajonit përkatës, sipas paragrafit 1. të nenit 33 të këtij udhëzimi administrativ dhe stema shtetërore. Në pjesën e poshtme horizontale duhet të shënohet numri treshifror, viza horizontale dhe kombinimi i shkronjës R, duke filluar me RA, shih shtojcën katër (4). Ndërsa korniza me ngjyrë të zezë me gjerësi 2 mm, shih shtojcën pesë (5).

Neni 36
Përmbajtja e targave për makina bujqësore

1. Targat katrore për makinat bujqësore dhe speciale, si dhe për rimorkio të tyre, kanë madhësinë e njëjtë me targat katrore kurse përmbajtja, ngjyra dhe shkronjat duhet të jenë si në vijim:

1.1. Targa është e ndarë në dy pjesë të barabarta në drejtim horizontal me diametër 34 x 20 cm;

1.2. Në pjesën horizontale të sipërme të targës vendoset kodi i Republikës së Kosovës RKS, me ngjyrë të kaltër, shkronjat për kodin me ngjyrë ari, shifra e rajonit përkatës, sipas paragrafit 1. të nenit 33 të këtij udhëzimi administrativ dhe stema shtetërore;

1.3. Në pjesën e poshtme horizontale duhet të jetë numri treshifror, viza horizontale dhe në fund të targës shënohen dy shkronja të alfabetit standard latin, kombinimi do të bëhet me shkronjat V dhe W e kombinuar me shkronjat tjera, duke filluar nga shkronjat VA;

1.4. Targa e makinave bujqësore duhet të ketë sipërfaqen e targës me ngjyrë të gjelbër retro-reflektuese, ndërsa numrat treshifror dhe shkronjat duhet të jenë me ngjyrë të bardhë, dhe korniza me ngjyrë të zezë me diametër 4 mm, shih shtojcën gjashtë (6);

1.5. Targat për rimorkio të makinave bujqësore dhe speciale me diameter 34 x 20 cm, duhet të kenë sipërfaqen e targës me ngjyrë të bardhë retro reflektuese, ndërsa numrat treshifror dhe shkronjat duhet të jenë me ngjyrë të kaltër, korniza me ngjyrë të zezë me diametër 4 mm;

1.6. Në pjesën e sipërme horizontale të targës, vendoset kodi i Republikës së Kosovës RKS, me ngjyrë të kaltër, shkronjat për kodin me ngjyrë ari, shifra e rajonit përkatës, sipas paragrafit 1, të nenit 33 të këtij udhëzimi administrativ dhe stema shtetërore;

1.7. Në pjesën e poshtme horizontale duhet të jetë numri treshifror, viza horizontale dhe në fund të targës shënohen dy shkronja të alfabetit standard latin, kombinimi do të bëhet me shkronjen T e kombinuar me shkronjat tjera duke filluar nga shkronjat TA, shih shtojcën shtatë (7).

Neni 37
Përmbajtja e targave për automjetet e institucioneve qendrore

1. Targat horizontale të mjeteve duhet të jenë me ngjyrë të bardhë retro-reflektuese, numrat dhe shkronjat me ngjyrë të zezë, ndërsa korniza me ngjyrë të zezë me gjerësi katër (4) mm. Në të gjitha targat horizontale në pjesën e parë vertikale të targës e cila është ngjyrë e kaltër, vendoset kodi i Republikës së Kosovës RKS, me ngjyrë ari. Targat për automjetet e institucioneve qendrore janë të përshkruara sipas specifikave si në vijim:

1.1. Për Presidencën e Kosovës, në pjesën e parë vertikale të targës, vendoset kodi i Republikës së Kosovës RKS, shenja identifikuese zyrtare 1Z, (në tekstin e mëtejme shkronja Z simbolizon termin: zyrtar) stemën shtetërore, numrin treshifror, vizën horizontale dhe numrin 01, shih shtojcën tetë (8);

1.2. Për Kuvendin e Kosovës në pjesën e parë vertikale të targës, vendoset kodi i Republikës së Kosovës RKS, shenja identifikuese zyrtare 2Z, stema shtetërore dhe numri treshifror, viza horizontale dhe numri 02, shih shtojcën nëntë (9);

1.3. Për Qeverinë e Kosovës, në pjesën e parë vertikale të targës, vendoset kodi i Republikës së Kosovës RKS, shenja identifikuese zyrtare 3Z, stema shtetërore, numri treshifror, viza horizontale dhe dy numrat kombinues si në vijim:

- 1.3.1. për Zyrën e Kryeministrisë -----01, shih shtojcën dhjetë (10);
- 1.3.2. për Ministrinë e Punëve të Brendshme -----02, shih shtojcën njëmbëdhjetë (11);
- 1.3.3. për Ministrinë e Punëve të Jashtme-dhe Diasporës-----03, shih shtojcën dymbëdhjetë (12);
- 1.3.4. për Ministrinë e Drejtësisë -----05;
- 1.3.5. për Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve-----06;
- 1.3.6. për Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës -----08;
- 1.3.7. për Ministrinë e Arsimit, Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit-----09;
- 1.3.8. për Ministrinë e Ekonomisë -----10;
- 1.3.9. për Ministrinë e Zhvillimit Rajonal -----11;
- 1.3.10. për Ministrinë e Shëndetësisë -----12;
- 1.3.11. për Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal -----14;
- 1.3.12. për Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë-----15;
- 1.3.13. për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural -----16;
- 1.3.14. për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit -----17;
- 1.3.15. për Ministrinë për Kthim dhe Komunitete -----18;

1.4. Numri treshifror i targave të automjeteve zyrtare për stafin politik, të institucioneve qendrore, do të filloj nga numri 001.

2. Targat katrore për mjetet e institucioneve qendrore, duhet të jenë me ngjyrë të bardhë retro-reflektuese, numrat dhe shkronjat me ngjyrë të zezë, ndërsa korniza me ngjyrë të zezë, me gjerësi

prej katër (4) mm është e ndarë në dy pjesë të barabarta në drejtim horizontal, të përshkruara si në vijim:

2.1. Për Presidencën e Kosovës, në pjesën e parë horizontale janë kodi RKS, Kodi 1Z dhe stema shtetërore. Në pjesën e poshtme horizontale shënohen numrat treshifror, viza horizontale dhe numri 01, shih shtojcën trembëdhjetë (13);

2.2. Për Kuvendin e Kosovës, në pjesën e parë horizontale janë kodi RKS, shenja identifikuese zyrtare 2Z dhe stema shtetërore. Në pjesën e poshtme horizontale shënohen numrat treshifror, viza horizontale dhe numri 02, shih shtojcën katërbëdhjetë (14);

2.3. Për Qeverinë e Kosovës, në pjesën e parë horizontale janë kodi RKS, shenja identifikuese zyrtare 3Z, dhe stema shtetërore. Në pjesën e poshtme horizontale shënohen numrat treshifror, viza horizontale dhe dy numrat kombinues, sipas nënparagrafit 1.3 të këtij neni, shih shtojcën pesëmbëdhjetë (15).

Neni 38

Përmbajtja e targave për mjettet e institucioneve të pushtetit lokal

1. Në nivelin lokal targat zyrtare të mjeteve me numra 01 do t'i jepen vetëm kryetarëve të komunave. Ndërsa duke filluar nga numri 02 deri në 99 do të t'i jepen nënkryetarit të komunës dhe drejtorëve të drejtorateve përkatëse, shih shtojcën gjashtëmbëdhjetë (16).

2. Përmbajtja e targave është e rregulluar si në paragrafin 3. të këtij neni.

3. Targat horizontale për institucionet e pushtetit lokal sipas rajoneve në Republikën e Kosovës, në pjesën e parë vertikale të targës, vendoset kodi i Republikës së Kosovës RKS, me ngjyrë të kaltër, në vazhdim shkronjat për kodin me ngjyrë ari. Numri identifikues i rajonit, sipas paragrafit 1. të nenit 33 të këtij udhëzimi administrativ, shkronja Z, stema shtetërore, numri dyshifror, viza horizontale dhe numri i komunës përkatëse sipas Ligjit për Kufijtë Administrativ të Komunave.

4. Targa katrore për institucionet e pushtetit lokal është e ndarë në dy pjesë të barabarta në drejtim horizontal, të përcaktuara si në paragrafin 5. të këtij neni.

5. Në pjesën e sipërme horizontale të targës është i vendosur kodi i Republikës së Kosovës RKS, me ngjyrë të kaltër, shkronjat për kodin me ngjyrë ari, numri i rajonit përkatës, sipas paragrafit 1. të nenit 33 të këtij udhëzimi administrativ, shkronja Z dhe stema shtetërore. Në pjesën e poshtme horizontale shënohen numrat dyshifror, viza horizontale dhe numri i komunës përkatëse sipas Ligjit për Kufijtë Administrativ të Komunave, shih shtojcën shtatëmbëdhjetë (17).

Neni 39

Përmbajtja e targave provuese

1. Targat provuese duhet të jenë nga materiali i plastifikuar me ngjyrë të bardhë retro-reflektuese, shkronjat dhe numrat duhet të jenë me ngjyrë të zezë, korniza e zezë me gjerësi 4 mm, përmbajtja e targës është si në paragrafin 2. të këtij neni.

2. Targa horizontale provuese ka dimensione 52 x 11 cm, në pjesën e parë vertikale të targës vendoset kodi i Republikës së Kosovës RKS, me ngjyrë të kaltër, shkronjat për kodin me ngjyrë ari. Në vazhdim të targës në pjesën lartë shënohet me shkronja të shtypit fjala, PROBATION, ndërsa në vazhdim poshtë shënohet shifra e targës provuese PR, viza horizontale, numrat treshifror. Në fund të targës shënohen dy shkronja të alfabetit standard latin duke filluar me shkronja kombinuese AA, shih shtojcën tetëmbëdhjetë (18).

Neni 40 **Përmbajtja e targave të përkohshme**

1. Targat e përkohshme horizontale të mjeteve duhet të jenë me ngjyrë të bardhë retro-eflektuese, numrat dhe shkronjat me ngjyrë të zezë, ndërsa korniza me ngjyrë të zezë me gjerësi katër (4) mm si në vijim:

1.1. Në pjesën e parë vertikale të targës, vendoset kodi i Republikës së Kosovës RKS, me ngjyrë të kaltër, shkronjat për kodin me ngjyrë ari. Në vazhdim shënohen dy shkronja të alfabetit standard latin RP që do të thotë: Regjistrimi i përkohshëm, në vijim duhet të jetë stema shtetërore, numrat treshifror, pastaj viza horizontale. Në fund të targës shënohen dy shkronja të alfabetit standard latin duke filluar me kombinimin AA, shih shtojcën nëntëmbëdhjetë (19);

1.2. Targat e përkohshme katrore për automjete duhet të jenë me ngjyrë të bardhë retro-reflektuese, numrat dhe shkronjat me ngjyrë të zezë, ndërsa korniza me ngjyrë të zezë me gjerësi prej katër (4) mm si në vijim: Targa e formës katrore është e ndarë në dy pjesë të barabarta në drejtim horizontal. Në pjesën horizontale të sipërme të targës, vendoset kodi i Republikës së Kosovës RKS me ngjyrë të kaltër, shkronjat për kodin me ngjyrë ari. Në vazhdim shënohen dy shkronja të alfabetit standard latin RP, që do të thotë: Regjistrimi i përkohshëm dhe stema shtetërore. Në pjesën e poshtme horizontale duhet të jetë numri treshifror, viza horizontale dhe në fund të targës shënohen dy shkronja të alfabetit standard latin sipas kombinimit duke filluar me shkronjen AA, shih shtojcën njëzetë (20).

2. Targat e përkohshme për motoçikleta duhet të jenë me ngjyrë të bardhë retro-eflektuese, numrat dhe shkronjat me ngjyrë të zezë, ndërsa korniza me ngjyrë të zezë me gjerësi dy (2) mm si në vijim:

2.1. Targa e përkohshme për motoçikleta me dimensione 24x13 cm është e ndarë në dy pjesë të barabarta në drejtim horizontal. Në pjesën e parë horizontale të targës vendoset kodi i Republikës së Kosovës RKS, me ngjyrë të kaltër, shkronjat për kodin me ngjyrë ari. Në vazhdim të targës shënohen dy shkronja të alfabetit standard latin RP, që do të thotë regjistrimi i përkohshëm dhe stema shtetërore. Në pjesën e poshtme horizontale të targës duhet të jetë numri treshifror, viza horizontale dhe në fund të targës shënohen dy shkronja të alfabetit standard latin sipas kombinimit duke filluar me AA, shih shtojcën njëzetënjë (21);

2.2. Për targat e përkohshme për motoçikleta me dimensione 10 x 15 cm në pjesën e parë horizontale të targës e cila është me ngjyrë të kaltër, vendoset kodi i Republikës së Kosovës RKS, me ngjyrë ari. Në vazhdim të targës shënohen dy shkronja të alfabetit standard latin RP që do të thotë regjistrimi i përkohshëm dhe stema shtetërore. Në mesin e pjesës së dytë

horizontale duhet të jetë numri treshifror. Në pjesën e poshtme horizontale duhet të shënohet viza horizontale, dy shkronja të alfabetit standard latin sipas kombinimit duke fillur me shkronjën AA, shih shtojcën njëzetedy (22).

Neni 41

Përmbajtja e targave për mjete me vlerë muzeore dhe gara

1. Targat horizontale të mjeteve me vlerë muzeore dhe gara, duhet të jenë me ngjyrë të bardhë retro-reflektuese, numrat dhe shkronjat me ngjyrë të zezë, ndërsa korniza me ngjyrë të zezë me gjerësi katër (4) mm si në vijim:

1.1. Në pjesën e parë vertikale të targës, me vlerë muzeore, vendoset kodi i Republikës së Kosovës RKS, me ngjyrë të kaltër, shkronjat për kodin me ngjyrë ari. Në vazhdim të targës shënohet me shkronja të shtypit fjala HISTORIK, në vijim duhet të jetë stema shtetërore, numrat treshifror duke filluar nga 001 dhe viza horizontale. Në fund të targës vendoset simboli i Hyjneshës në Fron ngjyrë ari, ndërsa sipërfaqja e simbolit ngjyrë e kaltër, shih shtojcën njëzetetre (23);

1.2. Targat katrore të mjeteve me vlerë muzeore duhet të jenë me ngjyrë të bardhë retro-reflektuese, numrat dhe shkronjat me ngjyrë të zezë, ndërsa korniza me ngjyrë të zezë me gjerësi prej katër (4) mm si në vijim: Targa e formës katrore është e ndarë në dy pjesë të barabarta në drejtim horizontal. Në pjesën horizontale të sipërme të targës vendoset kodi i Republikës së Kosovës RKS, me ngjyrë të kaltër, shkronjat për kodin me ngjyrë ari. Në vazhdim të targës me shkronja të shtypit është fjala HISTORIK, dhe stema shtetërore. Në pjesën e poshtme horizontale duhet të jetë numri treshifror, viza horizontale. Në fund të targës vendoset simboli i Hyjneshës në Fron ngjyrë ari, ndërsa sipërfaqja e simbolit ngjyrë e kaltër, shih shtojcën njëzetekatër (24).

2. Format e targave për motoçikleta të mjeteve me vlerë muzeore janë me dimensione 24x13 cm dhe 10x15cm. Duhet të jenë me ngjyrë të bardhë retro - reflektuese, numrat dhe shkronjat duhet të jenë me ngjyrë të zezë, korniza me ngjyrë të zezë me gjerësi dy (2) mm. Targa është e ndarë në dy pjesë të barabarta në drejtim horizontal me përmbajtje si në vijim:

2.1. Në pjesën horizontale të sipërme të targës vendoset kodi i Republikës së Kosovës RKS, me ngjyrë të kaltër, shkronjat për kodin me ngjyrë ari. Në vazhdim të targës me shkronja të shtypit është fjala HISTORIK, dhe stema shtetërore. Në pjesën e poshtme horizontale duhet të jetë numri treshifror, viza horizontale. Në fund të targës vendoset simboli i Hyjneshës në Fron ngjyrë ari ndërsa sipërfaqja e simbolit ngjyrë e kaltër, shih shtojcën njëzetepesë (25);

2.2. Në pjesën e parë vertikale të targës, për gara, vendoset kodi i Republikës së Kosovës RKS, me ngjyrë të kaltër, shkronjat për kodin me ngjyrë ari. Në vazhdim të targës, me shkronja të shtypit është fjala RACING që do të thotë gara. Stema e Republikës së Kosovës, shkronja R, viza horizontale dhe numri treshifror që do të filloj nga 001, shih shtojcën njëzetegjashtë (26);

2.3. Targat katrore të mjeteve për gara, duhet të jenë me ngjyrë të bardhë retro-reflektuese, numrat dhe shkronjat me ngjyrë të zezë, ndërsa korniza me ngjyrë të zezë me gjerësi prej katër (4) mm si në vijim: Targa e formës katrore është e ndarë në dy pjesë të barabarta në drejtim horizontal. Në pjesën horizontale të sipërme të targës vendoset kodi i Republikës së Kosovës RKS, me ngjyrë të kaltër, shkronjat për kodin me ngjyrë ari. Në vazhdim fjala RACING që do të thotë gara dhe stema shtetërore. Në pjesën e poshtme horizontale duhet të jetë shkronja R, vija horizontale dhe numri treshifror që do të fillojë nga 001, shih shtojcën njëzeteshtatë (27);

2.4. Targat e motoçikletave për gara duhet të jenë me ngjyrë të bardhë retro-reflektuese, numrat dhe shkronjat me ngjyrë të zezë, ndërsa korniza me ngjyrë të zezë me gjerësi prej katër (4) mm si në vijim: Targa për motoçikleta është e ndarë në dy pjesë të barabarta në drejtim horizontal. Në pjesën horizontale të sipërme të targës vendoset kodi i Republikës së Kosovës RKS, me ngjyrë të kaltër, shkronjat për kodin me ngjyrë ari. Në vazhdim, fjala RACING që do të thotë gara dhe stema shtetërore. Në pjesën e poshtme horizontale duhet të jetë shkronja R, vija horizontale dhe numri treshifror që do të fillojë nga 001, shih shtojcën njëzetetëtë (28).

Neni 42

Përmbajtja e targave për mjete me afat të kufizuar

1. Përmbajtja e targave për mjete me afat të kufizuar është si në vijim:

1.1. Targat për mjete me afat të kufizuar duhen të jenë me ngjyrë të bardhë retro-reflektuese, numrat dhe shkronjat me ngjyrë të zezë, korniza me ngjyrë të zezë, me gjerësi 4 mm. Përmbajtja e këtyre targave është si në vijim:

1.1.1. Te targat horizontale në pjesën e parë vertikale të targës, vendoset kodi i Republikës së Kosovës RKS, me ngjyrë të kaltër, shkronjat për kodin me ngjyrë ari. Në vazhdim të targës duhet të jenë shkronjat TAK që do të thotë “Targa me afat të kufizuar”, stema e Republikës së Kosovës RKS, numrat duke filluar nga 001 viza horizontale dhe kombinimi i dy shkronjave duke filluar nga AA, shih shtojcën njëzetentë (29);

1.1.2. Targat katrore të mjeteve me afat të kufizuar, duhet të jenë me ngjyrë të bardhë retro-reflektuese, numrat dhe shkronjat me ngjyrë të zezë, ndërsa korniza me ngjyrë të zezë me gjerësi prej katër (4) mm si në vijim: Targa e formës katrore është e ndarë në dy pjesë të barabarta në drejtim horizontal. Në pjesën horizontale të sipërme të targës vendoset kodi i Republikës së Kosovës RKS, me ngjyrë të kaltër, shkronjat për kodin me ngjyrë ari. Në vazhdim të targës duhet të jenë shkronjat TAK dhe stema shtetërore. Në pjesën e poshtme të targës duhet të jetë numri treshifror, vija horizontale dhe kombinimi i dy shkronjave duke filluar nga AA, shih shtojcën tridhjetë (30);

1.1.3. Format e targave të motoçikletave me afat të kufizuar janë me dimensione 24x13cm dhe 10 x 15cm. Përmbajtja e targave për motoçikleta me afat të kufizuar, duhet të jenë me ngjyrë të bardhë retro-reflektuese, numrat dhe shkronjat me ngjyrë të zezë, ndërsa korniza me ngjyrë të zezë me gjerësi prej katër (2) mm si në vijim: Targa për motoçikleta me dimensione 24x13cm, është e ndarë në dy pjesë të barabarta në drejtim horizontal. Në pjesën horizontale të sipërme të targës vendoset kodi i Republikës së Kosovës RKS, me

ngjyrë të kaltër, shkronjat për kodin me ngjyrë ari. Në vazhdim të targës duhet të jenë shkronjat TAK dhe stema shtetërore. Në pjesën e poshtme të targës duhet të jetë numri treshifror, viza horizontale dhe kombinimi i dy shkronjave duke filluar nga AA, shih shtojcën tridhjetenjë (31);

1.1.4. Targat me afat të kufizuar me dimensione 10 x 15 cm në pjesën e parë horizontale të targës e cila është me ngjyrë të kaltër, vendoset kodi i Republikës së Kosovës RKS, me ngjyrë ari. Në vazhdim të targës shënohen dy shkronja të alfabetit standard latin TAK që do të thotë targat me afat të kufizuar dhe stema shtetërore. Në mesin e pjesës së dytë horizontale duhet të jetë numri treshifror. Në pjesën e poshtme horizontale duhet të shënohet viza horizontale dhe dy shkronja të alfabetit standard latin sipas kombinimit duke filluar me AA, shih shtojcën tridhjetedy (32).

Neni 43

Targat për institucionet e pavarura të Republikës së Kosovës

1. Targat për institucionet e pavarura të Republikës së Kosovës bazuar në kapitullin XII të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ndahen si në vijim:

- 1.1. Targat për Avokatin e Popullit;
- 1.2. Targat për Auditorin e Përgjithshëm;
- 1.3. Targat për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve;
- 1.4. Targat për Bankën Qendrore të Kosovës;
- 1.5. Targat për Komisionin e Pavarur të Mediave.

2. Në targat horizontale për institucionet e pavarura në pjesën e parë vertikale vendoset kodi RKS, shenja identifikuese zyrtare 5Z dhe stema shtetërore, në pjesën tjetër të targës shënohen numrat treshifror, viza horizontale dhe dy numrat kombinues që fillojnë me 01, shih shtojcën tridhjetetë (33).

3. Në targat katrore për institucionet e pavarura në pjesën e parë horizontale është i vendosur kodi RKS, shenja identifikuese zyrtare 5Z dhe stema shtetërore. Në pjesën e poshtme horizontale shënohen numrat treshifror, viza horizontale dhe dy numrat kombinues që fillojnë me 01, shih shtojcën tridhjetekatër (34).

4. Targat e institucioneve të pavarura të përcaktuara në kapitullin XII të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, janë si në vijim:

- 4.1. Avokati i Popullit-----01, shih shtojcat tridhjetepesë (35), tridhjetegjashtë (36);

4.2. Auditori i Përgjithshëm-----02, shih shtojcat tridhjeteshtatë (37), tridhjetetëtë (38);

4.3. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve-----03, shih shtojcat tridhjetenëntë (39), dyzet (40);

4.4. Banka Qendrore e Kosovës-----04, shih shtojcat dyzetënjë (41), dyzetedy (42);

4.5. Komisioni i Pavarur i Mediave -----05, Shih shtojcat dyzetetre (43), dyzetekatër (44).

5. Agjencitë tjera të pavarura, të cilat janë në kuadër të Kuvendit sipas nenit 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovë, do të pajisen me targa sipas numrit të ardhshëm rendor nga paragrafi 4. i këtij neni.

Neni 44 **Përmbajtja e targave të Policisë**

1. Targat e Policisë duhet të jenë me ngjyrë të bardhë retro-reflektuese, shkronjat dhe numrat duhet të jenë me ngjyrë të kuqe, gjithashtu korniza e zezë në gjerësi katër (4) mm. Përmbajtja e këtyre targave është:

1.1. Te targat horizontale për policinë në pjesën e parë vertikale vendoset kodi i Republikës së Kosovës RKS. Në pjesën tjetër të targës duhet të shënohet me shkronja të shtypit fjala: POLICE. Në vazhdim shënohet stema shtetërore, numri treshifror, viza horizontale dhe dy numrat kombinues si në vijim:

1.1.1. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë -----01;

1.1.2. Policia Kufitare -----02;

1.1.3. Drejtoria Rajonale e Policisë, Prishtinë -----03;

1.1.4. Drejtoria Rajonale e Policisë, Mitrovicë -----04;

1.1.5. Drejtoria Rajonale e Policisë, Pejë -----05;

1.1.6. Drejtoria Rajonale e Policisë, Prizren-----06;

1.1.7. Drejtoria Rajonale e Policisë, Ferizaj -----07;

1.1.8. Drejtoria Rajonale e Policisë, Gjilan-----08;

1.1.9. Drejtoria Rajonale e Policisë, Gjakovë-----09; Shih shtojcën dyzetepesë (45).

1.2. Targa katrore e policisë është e ndarë në dy pjesë të barabarta në drejtim horizontal. Përmbajtja e këtyre targave është: Në pjesën horizontale të sipërme të targës vendoset kodi i Republikës së Kosovës RKS. Pastaj shënohet fjala: POLICE dhe stema shtetërore. Në pjesën

e poshtme horizontale shënohet numri treshifror, viza horizontale dhe dy numrat kombinues të cilët kanë domethënien e njëjtë me paragrafin 1.1. të këtij neni. Shih shtojcën dyzetegjashtë (46);

1.3. Targat për motoçikleta për policinë duhet të jenë me ngjyrë të bardhë retro-reflektuese, shkronjat dhe numrat duhet të jenë me ngjyrë të kuqe, korniza e zezë në gjerësi dy (2) mm, targa është e ndarë në tre (3) pjesë horizontale të barabarta me këtë përmbajtje. Në pjesën e parë horizontale vendoset kodi RKS dhe stema shtetërore. Në pjesën e dytë horizontale shënohet fjala: POLICE. Në pjesën e tretë horizontale shënohet numri treshifror, viza horizontale dhe dy numrat kombinues të cilët kanë domethënien e njëjtë me paragrafin 1.1. të këtij neni, shih shtojcën dyzeteshtatë (47);

1.4. Forma e targave për motoçikleta të policisë duhet të jenë me dimensione 24 x 13 cm dhe 10 x 15 cm, shih shtojcën dyzetetëtë (48).

Neni 45

Përmbajtja e targave të Doganës së Kosovës

1. Targat e Doganës së Kosovës duhet të jenë me ngjyrë të kaltër retro reflektuese, korniza me ngjyrë të zezë 4 mm, shkronjat dhe numrat duhet të jenë me ngjyrë të bardhë. Përmbajtja e këtyre targave është:

1.1. Në targat horizontale në pjesën e parë vertikale vendoset kodi i Republikës së Kosovës RKS, në pjesën tjetër të targës duhet të shënohet me shkronja të shtypit fjala: CUSTOMS. Në vazhdim shënohet stema shtetërore, numri treshifror, viza horizontale dhe shënohen dy shkronjat DG, që nënkupton Doganën, shih shtojcën dyzetentëtë (49);

1.2. Në targat katrore në pjesën horizontale të sipërme të targës vendoset kodi RKS, pastaj shënohet fjala: CUSTOMS, dhe stema shtetërore. Në pjesën e poshtme horizontale shënohet numri treshifror, viza horizontale dhe dy shkronjat DG, që nënkupton doganën. Shih shtojcën pesëdhjetë (50).

Neni 46

Përmbajtja e targave të Shërbimit të Emergjencave

1. Targat e Shërbimit të Emergjencës së zjarrfikësve duhet të jenë me ngjyrë të bardhë retro-reflektuese, shkronjat dhe numrat duhet të jenë me ngjyrë të kuqe, korniza me ngjyrë të kuqe në gjerësi katër (4) mm. Përmbajtja e këtyre targave është si në paragrafin 2. të këtij neni.

2. Te targat horizontale në pjesën e parë vertikale të targës e cila është me ngjyrë të kaltër, vendoset kodi i Republikës së Kosovës RKS, me ngjyrë ari. Në vazhdim të targës duhet të shënohet numri emergjent 112, stema shtetërore, numri treshifror, viza horizontale dhe dy numrat kombinues shih shtojcën pesëdhjetenjë (51) si në vijim:

2.1. për Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave vlen numri -----01;

2.2. për mjetet e Qendrave Rajonale Operative QRO, vlejné numrat si në vijim:

2.2.1. për QRO Prishtinë -----02;

2.2.2. për QRO Mitrovicë-----03;

2.2.3. për QRO Pejë-----04;

2.2.4. për QRO Prizren -----05;

2.2.5. për QRO Gjilan -----06;

2.2.6. për QRO Ferizaj -----07;

2.2.7. për QRO Gjakovë-----08, (Shih shtojcën pesëdhjetenjë (51).

3. Te targat katrore të shërbimit emergjent, në pjesën e parë horizontale të targës e cila është me ngjyrë të kaltër, vendoset kodi RKS, kurse shkronjat për kodin duhet të jenë ngjyrë ari. Shënohet numri emergjent 112 dhe stema shtetërore. Në pjesën e poshtme horizontale shënohet numri treshifror, viza horizontale dhe dy numrat kombinues të cilët kanë domethënien e njëjtë me paragrafin 2. të këtij neni, shih shtojcën pesëdhjetedy (52).

Neni 47

Targat për institucionet e sistemit të drejtësisë

1. Targat për institucionet e sistemit të drejtësisë ndahen si në vijim:

1.1. Targat për Gjykatën Kushtetuese;

1.2. Targat për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;

1.3. Targat për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

2. Targat horizontale të Gjykatës Kushtetuese në pjesën e parë vertikale të targës e cila është me ngjyrë të kaltër, vendoset kodi i Republikës së Kosovës RKS me ngjyrë ari. Në vazhdim të targës shenja identifikuese zyrtare 4Z dhe stema shtetërore, në pjesën tjetër të targës shënohen numrat treshifror, viza horizontale dhe dy numrat kombinues që fillojnë me 01, shih shtojcën pesëdhjetetë (53).

3. Targat katrore për Gjykatën Kushtetuese në pjesën e parë horizontale të targës e cila është me ngjyrë të kaltër, vendoset kodi RKS, kurse shkronjat për kodin duhet të jenë ngjyrë ari. Në pjesën e parë horizontale të targës duhet të jetë shenja identifikuese zyrtare 4Z dhe stema shtetërore. Në pjesën e poshtme horizontale shënohen numrat treshifror, viza horizontale dhe dy numrat kombinues që fillojnë me 01, shih shtojcën pesëdhjetekatër (54).

4. Te targat horizontale të automjeteve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës në pjesën e parë vertikale të targës e cila është me ngjyrë të kaltër, vendoset kodi i Republikës së Kosovës RKS me ngjyrë ari. Në vazhdim të targës shenja identifikuese zyrtare 4Z dhe stema shtetërore. Në pjesën tjetër të targës shënohet numri treshifror, viza horizontale dhe dy numrat kombinues që fillojnë me 02 si në vijim:

4.1. Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës-----001-02;

4.2. Kryetari i Gjykatës Supreme -----002-02;

4.3. Zv. Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës -----003-02;

4.4. Kryetari i Gjykatës së Apelit -----004-02,
shih shtojcën pesëdhjetepesë (55).

5. Ndërsa për mjetet tjera të Administratës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Gjykatave Themelore të cilat fillojnë nga pozita e Drejtorit të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të fillojnë nga 101-02.

6. Targat katrore për Këshillin Gjyqësor të Kosovës në pjesën e parë horizontale të targës e cila është me ngjyrë të kaltër, vendoset kodi i Republikës së Kosovës RKS, kurse shkronjat për kodin duhet të jenë me ngjyrë ari. Në pjesën e parë horizontale të targës duhet të jetë shenja identifikuese zyrtare 4Z dhe stema shtetërore. Në pjesën e poshtme horizontale shënohen numrat treshifror, viza horizontale dhe dy numrat kombinues që fillojnë me 02, shih shtojcën pesëdhjetegjashtë (56).

7. Në targat horizontale të mjeteve për Këshillin Prokurorial të Kosovës në pjesën e parë vertikale të targës e cila është me ngjyrë të kaltër, vendoset kodi i Republikës së Kosovës RKS, kurse shkronjat për kodin duhet të jenë me ngjyrë ari. Në vazhdim të targës shenja identifikuese zyrtare 4Z dhe stema shtetërore. Në pjesën tjetër të targës shënohet numri treshifror, viza horizontale dhe dy numrat kombinues që fillojnë me 03 si në vijim:

7.1. për Kryeprokurorin e Shtetit-----001-03;

7.2. për Zv. Kryeprokurorin e Shtetit-----002-03;

7.3. për Kryeprokurorin e Prokurorisë Speciale-----003-03,
shih shtojcën pesëdhjeteshtatë (57).

8. Mjetet tjera të (prokurorive) dhe të administratës së prokurorit të shtetit do të regjistrohen duke filluar nga 101 – 03.

9. Targat katrore për Këshillin Prokurorial të Kosovës në pjesën e parë horizontale të targës e cila është me ngjyrë të kaltër, vendoset kodi i Republikës së Kosovës RKS, kurse shkronjat për kodin duhet të jenë me ngjyrë ari. Në pjesën e parë horizontale të targës duhet të jetë shenja identifikuese 4Z dhe stema shtetërore. Në pjesën e poshtme horizontale shënohen numrat treshifror, viza horizontale dhe dy numrat kombinues që fillojnë me 03, shih shtojcën pesëdhjetetë (58).

Neni 48
Përmbajtja e Sistemit të Regjistrimit të Automjeteve

1. SRA përmban të dhënat si në vijim:
 - 1.1. Të dhënat mbi QRA-në;
 - 1.2. Numrin e rastit;
 - 1.3. Datën e aplikimit;
 - 1.4. Numrin e targave.
2. Të dhënat e pronarit të mjetit, përmbajnë
 - 2.1. Emrin e mbiemrin;
 - 2.2. Emrin e prindit;
 - 2.3. Datën e lindjes.
3. Të dhënat e përdoruesit të mjetit:
 - 3.1. Emri dhe mbiemri.
4. Të dhënat e mjetit:
 - 4.1. Marka;
 - 4.2. Modeli;
 - 4.3. Ndërtimi;
 - 4.4. Ngjyra;
 - 4.5. Numri i identifikues i mjetit;
 - 4.6. Viti i prodhimit;
 - 4.7. Lloji i motorit;
 - 4.8. Sasia e vendeve të ulëseve;
 - 4.9. Pesha pa ngarkesë;
 - 4.10. Kapaciteti i përgjithshëm;

- 4.11. Pesha maksimale e lejuar;
 - 4.12. Kapaciteti në cm. kub;
 - 4.13. Lloji i taksës sipas mjetit.
5. Të dhënat mbi regjistrimin e parë:
- 5.1. Data dhe vendi i regjistrimit të parë;
 - 5.2. Numri i targave të regjistrimit të parë.
6. Të dhënat tjera:
- 6.1. Numri dhe data e DUD-it;
 - 6.2. Data dhe numri i policës së sigurimit;
 - 6.3. Periudha e sigurimit;
 - 6.4. Numri i certifikatës së kontrollit teknik;
 - 6.5. Numri i fletëpagesës komunale;
 - 6.6. Vendi i lëshimit – QRA-ja;
 - 6.7. Data e lëshimit;
 - 6.8. Vlefshmëria e regjistrimit;
 - 6.9. Numri i CRA-së;
 - 6.10. Numri i targave.

Neni 49

Sistemi i Regjistrimit të Automjeteve

1. SRA duhet të ketë masa mbrojtëse të sigurisë.
2. Qasje në SRA duhet të kenë vetëm personat e autorizuar nga Drejtori i Përgjithshëm i ARC-së apo Drejtori i Drejtoratit për Regjistrim të Automjeteve.
3. SRA për shërbimet *online* do të përmbajë vetëm procedurat e vazhimit të regjistrimit të automjetit.

4. SRA është e ndërlidhur me institucionet tjera për thirrjen apo dërgimin e të dhënave përmes ueb shërbimeve.
5. Administrimi i Sistemit bëhet nga Sektori për Administrim me Baza të të Dhënave në ARC.

Neni 50

Ofrimi i të dhënave sipas kërkesës

1. Me procedurat e përcaktuara sipas këtij udhëzimi administrativ, Drejtorati për Regjistrimin e Automjeteve mund t'i afroje të dhënat kur ato kërkohen lidhur me:
 - 1.1. Kërkesën për ndihmë juridike lidhur me një procedurë administrative, gjyqësore ose me ndonjë qëllim tjetër të ligjshëm të një organi qeveritar ose joqeveritar brenda dhe jashtë Kosovës sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
 - 1.2. Kërkesën në lidhje me një hetim të pa përfunduar, sipas kërkesës nga policia dhe organet përkatëse për siguri që veprojnë në Kosovë, apo me kërkesën e Interpolit;
 - 1.3. Sipas kërkesës për një procedurë gjyqësore të papërfunduar civile ose penale, nga autoritetet gjyqësore;
 - 1.4. Për nevojat e zhvillimit të politikave në lëmit e caktuara sipas kërkesës së Kuvendit, Qeverisë apo ndonjë ministrie.

Neni 51

Lirimi nga taksat

1. Kategoritë e përcaktuara me legjislacionin përkatës në fuqi lirohen nga pagesa e taksës administrative, gjyqësore dhe publike.
2. Për kategoritë e liruara sipas legjislacionit në fuqi, kërkohet vendimi i MPMS-së dhe kartela e vlefshme.
3. Përfundimisht paragrafit 1. të këtij neni, të gjitha mjetet e pronarëve të cilat janë të liruara nga taksat, në rast se bëhet shitblerja e mjetit, paraprakisht, pala është e obliguar të bëjë çlajmërimin e mjetit.
4. Në rast të vdekjes së personit i cili e ka gëzuar pensionin e dëshmorit për pasardhësin e tij, nevojitet një dëshmi që e vërteton se është familje e dëshmorit.

Neni 52

Pajisja me dy palë targa

1. Institucioni shtetëror i cili ka të drejtë t'i ketë dy e më tepër targa për automjetin e njëjtë, do të përcaktohet me vendim të ministrit të MPB-së.

2. Institucioni shtetëror i cili ka të drejtë që përveç targave zyrtare të posedoj edhe targa civile, do të përcaktohet me vendim të ministrit të MPB-së, e në raste të veçanta edhe me aprovim të kërkesave.

Neni 53
Shqyrtimi i kërkesave nga komisioni

Për rastet që kërkojnë shqyrtim të kërkesave për procedurën e regjistrimit të mjetit, drejtori i Përgjithshëm i ARC-së, do ta themeloj me vendim Komisionin në përbërje prej 3 anëtarëve, që do t'i shqyrtoj këto raste dhe për secilin rast do të marrë vendim.

Neni 54
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, shfuqizohet Udhëzimi Administrativ (MPB) Nr.07/2019 për Regjistrimin e Mjeteve.

Neni 55
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Xhelal SVECLA
Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme

















































RKS

HISTORIK



000 -















































































Targat e motoçikletave (240 x 130 mm) - KSF

Shtojca nr.



Targat e motoçikletave (100 x 150 mm) - KSF

Shtojca nr.

